



XXe Congrès de la Conférence des Cours constitutionnelles européennes  
XXth Congress of the Conference of European Constitutional Courts  
XX. Kongress der Konferenz der Europäischen Verfassungsgerichte

CE  
CC

2024/27

**RREGULLORE E KONFERENCËS SË  
GJYKATAVE KUSHTETUESE EUROPIANE**

# **RREGULLORE E KONFERENCËS SË GJYKATAVE KUSHTETUESE EUROPIANE**

## **RRETHI I KRYETARËVE**

**Bruksel, 16 maj 2002**

### **Neni 1**

#### **Bazat**

Këto rregulla bazohen në Statutin e Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Europiane të miratuar në 16 – 17 maj 1999 në Varshavë.

### **Neni 2**

#### **Organizimi i Kongresit**

(Neni 3 i Statutit)

Konferenca e Gjykatave Kushtetuese zakonisht zhvillon një Kongres çdo tre vjet.

Kongresi përfshin një sesion hapjeje dhe një sesion mbylljeje si dhe diskutime.

### **Neni 3**

#### **Raportet kombëtare dhe raporti i përgjithshëm**

(Neni 9 i Statutit)

Në mbledhjen përgatitore Rrethi i Kryetarëve zgjedh temat dhe specifikon kërkesat për përgatitjen e raporteve kombëtare, përpilimin e pyetësorit dhe përcakton relatorin (relatorët) e përgjithshëm.

### **Neni 4**

#### **Zhvillimi i Kongresit**

(Neni 9 paragrafi 2 i Statutit)

Kongresi nis me një sesion solemn hapjeje. Ai mbaron me një sesion të veçantë mbylljeje.

Rrethi i Kryetarëve vendos nëse diskutimet do të zhvillohen në seanca plenare dhe /apo në grupe.

Rrethi i Kryetarëve cakton një kryesues për secilin grup.

Rrethi i Kryetarëve cakton për çdo Kongres kërkesat teknike për prezantimin e secilës temë nga relatorët si dhe për diskutimet e pjesëmarrësve.

## **Neni 5**

### **Vëzhguesit dhe të Ftuarit**

(Neni 5 dhe Neni 9 paragrafi 2 i Statutit)

Mund të pranohen si **vëzhgues**

1. Gjykata Europiane mbikombëtare (supranacionale) ;
2. Gjykata Kushtetuese Europiane dhe institucione të ngjashme brenda Europës të cilat nuk kërkojnë ende anëtarësim të plotë apo të pjesshëm ;
3. Komisionet dhe institucionet e Këshillit të Europës dhe të Bashkimit Europian që merren në mënyrë të veçantë me çështjet e drejtësisë kushtetuese ;
4. Gjykatat Kushtetuese jo-Europiane dhe institucione të ngjashme.

Mund të pranohen si **të ftuar** :

1. Gjykatat e Larta të vendit pritës ;
2. Gjykata të tjera europiane dhe jo-europiane ;
3. Institucione të tjera që trajtojnë çështje të drejtësisë kushtetuese ;
4. Individë

Gjykata pritëse propozon në mbledhjen përgatitore se cilët vëzhgues dhe të ftuar do të ftohen në Kongresin e ardhshëm.

Rrethi i Kryetarëve mund të pranojë një ditë para hapjes së Kongresit të tjerë vëzhgues dhe të ftuar në Kongres.

## **Neni 6**

### **Të drejtat e pjesëmarrjes së anëtarëve të asociuar**

(Neni 4, paragrafi 2 i Statutit dhe Neni 10 i Statutit)

Anëtarët e asociuar kanë të drejtat e pjesëmarrjes si vijon :

1. pjesëmarrje në Kongres ;
2. prezantim të një raporti kombëtar mbi temën specifike të Kongresit ;
3. pjesëmarrje në debate ;
4. paraqitje me shkrim e propozimeve Rrethit të Kryetarëve.

## **Neni 7**

### **Të drejtat e pjesëmarrjes të vëzhguesve dhe të të ftuarve.**

(Neni 5 dhe Neni 10 i Statutit)

Vëzhguesit kanë të drejtat e pjesëmarrjes si më poshtë:

1. Pjesëmarrje në Kongres;
2. Prezantimi i një raporti mbi temat specifike të Kongresit;
3. Pjesëmarrje në debate.

Të ftuarit kanë të drejta pjesëmarrjeje si më poshtë:

1. Pjesëmarrje në sesionet e Kongresit;
2. Në raste të veçanta, kryesuesi i sesionit mund t'u lejojë të marrin pjesë në debate.

## **Neni 8**

### **Lista e pjesëmarrësve**

Për mbledhjen përgatitore dhe Kongresin Gjykata pritëse pajis pjesëmarrësit me një listë të përditësuar të të gjithë anëtarëve me të drejta të plota që kanë të drejtë vote, të anëtarëve të asociuar, të vëzhguesve dhe të të ftuarve.

## **Neni 9**

### **Rrethi i Kryetarëve**

(Neni 9 paragrafi 4 dhe 5, dhe Neni 12 i Statutit)

Rrethi i Kryetarëve mbledhet në ditën që paraprin hapjen e Kongresit dhe gjithashtu para mbylljes së Kongresit.

Në përgjithësi një mbledhje përgatitore mbahet në vitin e parë pas Kongresit të fundit për të përgatitur Kongresin e ardhshëm.

Nëse gjykohet e nevojshme mund të mbahen mbledhje të tjera të Rrethit të Kryetarëve.

Vendimet mund të merren me anë të qarkores rezolutë.

## **Neni 10**

### **Agjenda**

(Neni 9 i Statutit)

Ftesa me shkrim për pjesëmarrje në mbledhjet e Rrethit të Kryetarëve shoqërohet me agjendën e mbledhjes.

Agjenda përmend temat e debateve (shih materialin bashkëlidhur). Ajo mund të plotësohet apo të ndryshohet në fillim të mbledhjes.

Vendimet e marra shkruhen në proces-verbalin e mbledhjes.

Anëtarët me të drejta të plota dhe anëtarët e asociuar marrin proces-verbalet me shkrim.

## **Neni 11**

### **Komitetet (grupet e punës)**

Rrethi i Kryetarëve mund të krijojë grupe që përpilojnë raporte që lidhen me çështje të veçanta, të tilla si pranimi apo refuzimi i Gjykatave Kushtetuese apo institucioneve të ngjashme ose lidhur me çështje organizative të Konferencës.

## **Neni 12**

### **Gjuhët**

(Neni 9 paragrafi 2 i Statutit)

Gjuhët zyrtare të debateve gjatë Kongresit dhe në Rrethin e Kryetarëve janë Frëngjisht, Anglisht, Gjermanisht, Rusisht dhe, kur është e nevojshme një gjuhë tjetër zyrtare e gjykatës së vendit pritës e shoqëruar me përkthim simultan.

Anëtarët mund të kërkojnë përkthim simultan në gjuhë të tjera me shpenzimet e tyre. Gjykata pritëse merr masa teknike brenda mundësive për përkthimin simultan shtesë ose deklaron mundësitë përse nuk mund të realizohet. Nëse ka probleme që lidhen me faktin se ka shumë kërkesa, prioritet do t'u jepet vendeve që kanë kohën më të gjatë të anëtarësisë.

Rrethi i Kryetarëve mund të kërkojë që të lejohet që një përkthyes të përkthejë fjalën e një delegacioni, me shpenzimet e këtij të fundit, në një nga gjuhët zyrtare.

Raporti kombëtar me shkrim do të prezantohet në gjuhën zyrtare të vendit anëtar dhe po ashtu në Frëngjisht ose Anglisht.

Raporti i përgjithshëm do të shkruhet në Frëngjisht dhe në Anglisht.

Gjykata pritëse si shtesë mund ta botojë raportin e përgjithshëm në një nga gjuhët e veta zyrtare.

### **Neni 13**

#### **Rendi i uljes (i vendosjes në sallë)**

Në Rrethin e Kryetarëve dhe në Kongres, anëtarët me të drejta të plota ulen në përgjithësi sipas rradhës së pranimit të tyre si anëtare me të drejta të plota; nëse janë pranuar në të njëjtën kohë ata ulen duke respektuar rendin alfabetik.

Në Kongres, anëtarët me të drejta të plota duhet të ulen përballë – lart, të ndjekur nga anëtarët e asociuar, vëzhguesit dhe të ftuarit. Rendi i uljes i anëtarëve të asociuar, vëzhguesve dhe të ftuarve është i njëjtë si me atë të anëtarëve me të drejta të plota.

Gjykata pritëse mund të ndryshojë rendin e vendosjes për arsye të barazisë.

### **Neni 14**

#### **Media dhe publiciteti**

(Neni 12 i Statutit)

Media (shtypi, radio, televizioni) ftohen në sesionet e hapjes dhe të mbylljes. Rrethi i Kryetarëve vendos nëse këto dy sesione janë të hapura edhe për ndonjë person tjetër.

Debatet nuk janë publike.

Mbledhjet e Rrethit të Kryetarëve nuk janë të hapura për publikun.

### **Neni 15**

#### **Kontributi financiar i anëtarëve me të drejta të plota.**

(Neni 4 paragrafi 1, Neni 9, paragrafi 2/d, Neni 11 paragrafi 1, 2/a dhe 3 i Statutit)

Në parim, anëtarët me të drejta të plota i mbulojnë vetë shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit në hotel.

Kostot e përgjithshme të organizimit të Kongresit, të cilat ndahen në mënyrë të barabartë sipas nenit 11 paragrafi 2/a i Statutit, janë si më poshtë:

1. Qeraja e ambjenteve;
2. Kostoja e printimit;
3. Kostoja e përkthimit të dokumentave të shkruar
4. Kostoja e interpretimit;
5. Shpenzime administrative;
6. Kostot e transportit lokal.

Rrethi i Kryetarëve vendos nëse dhe deri në ç'masë kostot e mëposhtme mund të jenë pjesë e kostove të përgjithshme të Konferencës në përputhje me Nenin 11 paragrafi 2/a të Statutit:

1. Kostot e ushqimit;
2. Kostot e ndonjë ekskursioni të mundshëm;
3. Kostot specifike për pajisjen me një Site internet për Konferencën;
4. Kostot për masa të veçanta sigurie

Rrethi i Kryetarëve vendos edhe për numrin e delegatëve për çdo vend kostot e të cilëve do të mbulohen nga buxheti i Konferencës.

## **Neni 16**

### **Kontributi financiar i anëtarëve të asociuar dhe vëzhguesve**

(Neni 4 paragrafi 2 dhe Neni 11 paragrafi 2/b i Statutit)

Anëtarët e asociuar dhe vëzhguesit i mbulojnë vetë shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit në hotel.

Anëtarëve të asociuar dhe vëzhguesve mund t'u kërkohej të paguajnë një kuotë për pjesëmarrjen për secilin pjesëmarrës. Kjo kuotë përfshin koston e ushqimit, një ekskursion të mundshëm si dhe një shumë të reduktuar fikse të kontributit në kostot e përgjithshme të Konferencës të caktuara sipas Nenit 11 paragrafi 2/a të Statutit.

Kostot e programeve speciale vendosen në fatura të ndara.

Shuma e kuotës së pjesëmarrjes vendoset në bazë të propozimit të bërë nga gjykata pritëse.

## **Neni 17**

### **Kontributi financiar i të ftuarve**

(Neni 5 i Statutit)

Në përgjithësi, të ftuarit i mbulojnë vetë shpenzimet e udhëtimit dhe të hotelit.

Të ftuarit nuk kontribuojnë në kostot e përgjithshme të Konferencës të caktuara sipas Nenit 11 paragrafi 2/a të Statutit dhe nuk paguajnë për kostot e ushqimit apo për ndonjë ekskursion të mundshëm.

Në përgjithësi, kostot e programeve speciale u ngarkohen të ftuarve.

Gjykata pritëse është e lirë të mbulojë të gjitha kostot e tjera në mënyrë të plotë apo të pjeshme.

Rrethi i Kryetarëve mund të vendosë nëse këto kosto do të jenë pjesërisht apo plotësisht të përfshira në kostot e përgjithshme të Konferencës.

## **Neni 18**

### **Hyrja në fuqi**

(Neni 14 i Statutit)

Këto rregulla të Konferencës hyjnë në fuqi ditën e miratimit nga Rrethi i Kryetarëve.

Ato hartohen në Frëngjisht, Anglisht, Gjermanisht dhe Rusisht.

Versioni autentik është ai në Frëngjisht.

I miratuar njëzëri me votim final të Rrethit të Kryetarëve në 16 Maj 2002, në Bruksel.

Në vitin 2012 teksti u botua për të korrigjuar gabime daktilografike dhe gjuhësore.